



URDHRI I INFERMIERIT
TE SHQIPERISE

92 dat 15.3.2010



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

K-1838 dat 15.3.2010

**MEMORANDUM MIREKUPTIMI
NDERMJET
MINISTRISE SE MBROJTJES
DHE
URDHERIT TE INFERMIERIT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE**

Ministria e Mbrojtjes dhe Urdhri i Infermierit në Republikën e Shqipërisë, këtej e tutje të quajtura " Palë ", me qëllim zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe reformës në shërbimin shëndetësor, për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të standardeve të ushtrimit profesional dhe të cilësisë në kujdesin infermior, pranojnë domosdoshmërinë për bashkëpunim në partneritet dhe bien dakord që ta realizojnë këtë bashkëpunim si më poshtë:

Neni 1

Urdhri i Infermierit të Republikës së Shqipërisë e konsideron Ministrinë e Mbrojtjes si partner dhe shpreh angazhimin ta mbështesë atë në zbatimin e politikave dhe strategjisë së zhvillimit të sistemit shëndetësor për kujdesin infermior

Neni 2

Ministria e Mbrojtjes angazhohet të mbështesë urdhrin e infermierit në përmbushjen e misionit të tij në të gjitha institucionet shëndetësore që mbulon ky dikaster. Gjithashtu angazhohet të përfshijë Urdhrin e Infermiereve, në hartimin dhe diskutimin e akteve ligjore, dokumenteve të tjera të rëndësishme për kujdesin infermior.

Neni 3

Ministria e Mbrojtjes mbështet parimin për implementimin e procesit të licencimit dhe të ri-licencimit profesional individual të infermier-mami-fizioterapeuteve, si detyrim për ushtrimin e profesionit në sistemin publik dhe privat të shërbimeve mjekësore duke mos punësuar asnjë infermier-mami-fizioterapeut pa qenë anëtar i Urdhrit të Infermierit.

Në mbështetje e zbatim të nenit 5, ë ligjit nr. 9718 datë 29.04.2007 "Për Urdhrin e Infermierit të Republikës së Shqipërisë", Ministria e Mbrojtjes do të ushtrojë kompetencat e saj ndaj institucioneve në vartësi, për të mos lejuar punësimin e infermier-mami-fizioterapeutëve, pa qenë të pajisur paraprakisht me dokumentin e anëtarësimit në urdhrin e infermierëve.

Neni 4

Ministria e Mbrojtjes dhe Urdhri i Infermierëve në bashkëpunim dhe mirëkuptim të ndër-sjelltë angazhohen të ndjekin masat organizative për futjen dhe përshpejtimin e aplikimit të edukimit të vazhdueshëm profesional mjekësor të infermierëve-mami-fizioterapeutëve, duke përfshirë në këtë proces shoqatat profesionale-shkencore të kësaj kategorie, stafin akademik të fakultetit të infermierisë si dhe aktorë të tjerë.

Neni 5

Palët në bashkëpunim do të organizojnë ushtrimin e kontrolleve mbi standardet e ushtrimit profesional, problemet e sjelljes etiko-morale dhe korrupsioni në kujdesin infermior, duke zbatuar me korrektësi kodin etiko-deontologjik të Urdhrit të Infermierit.

Neni 6

Palët marrin angazhimin e përbashkët për të transmetuar frymën e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit që mbart nënshkrimi i këtij memorandumit, në të gjitha strukturat e tyre qendrore dhe lokale.

Sot, më datë 15 / 03 / 2010, lidhet kjo Marrëveshje Mirëkuptimi, e hartuar në 4 (katër) kopje origjinale nga 2 (dy) për secilën palë.

PER MINISTRINE E MBROJTJES

PER URDHRIN E INFERMIERIT

MINISTRI

PRESIDENTI

